

JOSEP BORRELL FONTELLES

PËRFAQËSUESI I LARTË
NËNPRESIDENT I KOMISIONIT EVROPIAN

Bruksel, 30 tetor 2020
A(2020)5278451-6788457

Z. Syed Riaz Haider
Ushtrues i detyrës së shefit të Njesisë për Administrimin e Gjykatës
Dhomat e Specializuara të Kosovës
Hagë

I nderuar z. Haider,

Ju faleminderit që keni pranuar kërkesën tonë për zgjatjen e afatit për paraqitjen e parashtrimeve me shkrim në përgjigje të Njoftimit për Referimin dhe Kërkesës për Informacion nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, e transmetuar më 5 tetor. Me anë të kësaj shkrese, paraqes parashtrimin tim me shkrim për pranueshmërinë e Referimit.

Ju lutem, pranoni konsideratat e mia më të larta.

Sinqerisht i Juaji,

/nënshkrim/

Josep Borrell Fontelles

Bruksel, 30 tetor2020

Në procedimin e Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese

Parashtrim me shkrim nga Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit për Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë për pranueshmërinë e Referimit

- Lënda: Dosja KSC-CC-2020-11: Referim mbi ndryshimet e propozuara të Kushtetutës së Kosovës (*)
- Referencat: 1) Vendimi KSC-CC-2020-11/F00004 i 5 tetorit 2020 mbi Njoftimin për referimin dhe kërkesën për informacion;
- 2) Vendimi KSC-CC-2020-11/F00012 i 20 tetorit 2020 mbi kërkesën për zgjatjen e afatit për paraqitjen e parashtrimeve me shkrim.

HISTORIKU

1. Më 14 prill 2014, Presidentja e Kosovës dhe Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe të Sigurisë/Zëvendës-presidentja e Komisionit Evropian shkëmbyen letra në lidhje me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe themelimin dhe funksionimin e një "gjykate të specializuar" dhe një "zyre të prokurorit të specializuar" për procedura që mund të rezultojnë nga hetimet e Task Forcës Hetimore Speciale (TFHS) ("Shkëmbimi i Letrave").
2. Më 23 prill 2014, Kuvendi i Kosovës, me anë të ligjit nr. 04/L-274, ratifikoi Shkëmbimin e Letrave si një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
3. Më 3 gusht 2015, Kuvendi i Kosovës e ndryshoi Kushtetutën duke e shtuar nenin 162 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

(*) Ky emërtim nuk e paragjykon pozitën në lidhje me statusin, dhe është në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimi të OKB-së 1244 (1999) dhe Opinionin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë nga Kosova.

PROCEDURA

4. Më 24 gusht 2020, Presidenti i Kosovës propozoi një amendament të nenit 162 të Kushtetutës (“amendamenti i propozuar”).
5. Më 18 shtator 2020, Kryetarja e Kuvendit të Kosovës i përcolli Kryetares së Dhomave të Specializuara amendamentin e propozuar, në pajtim me nenet 144(3) dhe 162(3) të Kushtetutës (“referimi”), për të shqyrtuar nëse amendamenti i propozuar kushtetues nuk i pakëson të drejtat dhe liritë e garantuara në Kapitullin II të Kushtetutës.
6. Më 22 shtator 2020, Kryetarja e Dhomave të Specializuara caktoi panelin me e Gjykatës Kushtetuese, për të marrë vendim mbi referimin.
7. Më 5 tetor 2020, paneli i Gjykatës Kushtetuese vendosi të njoftonte në mes të tjerëve, Përfaqësuesin e Lartë, me mundësinë që ai të paraqiste, deri më 19 tetor 2020, nëse dëshironte, parashtrim me shkrim për pranueshmërinë dhe/ose themelësinë e Referimit.
8. Më 19 tetor 2020, Përfaqësuesi i Lartë i kërkoi panelit që ta zgjaste deri më 2 nëntor 2020 afatin për paraqitjen e parashtrimeve me shkrim për pranueshmërinë dhe/ose themelësinë e Referimit.
9. Më 20 tetor 2020, paneli i Gjykatës Kushtetuese e miratoi kërkesën e Përfaqësuesit të Lartë për zgjatjen e afatit për paraqitjen e parashtrimeve me shkrim për pranueshmërinë dhe/ose themelësinë e Referimit, dhe e zgjati këtë afat për Përfaqësuesin e Lartë deri më 2 nëntor 2020.

PARASHTRIM PËR PRANUESHMËRINË

10. Neni 162(14) i Kushtetutës parasheh që ‘ ..., mandati i Dhomave të specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar do të vazhdojë deri kur njoftimi i përfundimit të mandatit të bëhet në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-274 dhe në konsultim me Qeverinë.’
11. Amendamenti i propozuar parasheh fshirjen e paragrafëve 13 dhe 14 aktualë të nenit 162 të Kushtetutës. Ai parashikon paragrafin 13 të ri si më poshtë për të zëvendësuar ato dispozita: ‘mandati i Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar do të vazhdojë deri kur njoftimi i përfundimit të mandatit të bëhet nga Këshilli i Bashkimit Evropian, në konsultim me Qeverinë e Kosovës.’

12. Meqenëse amendamenti i propozuar ka për qëllim ndryshimin e një dispozite kushtetuese 'që ka ndikim në procedurat gjyqësore që burojnë nga hetimet e TFHS-së', ai bën pjesë në kategorinë përkatëse të ndryshimeve të cilave u referohet Shkëmbimi i Letrave.
13. Në Shkëmbimin e Letrave thuhet: 'ne do të marrim përsipër, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi në Kosovë, me shefin e Misionit EULEX Kosova dhe/ose PSBE-në (siç kërkohet), të gjitha zotimet dhe modalitetet përcjellëse për të mundësuar funksionimin efektiv të misionit EULEX Kosova, duke përfshirë konsultimet në procesin e ndryshimplotësimit të ligjeve që kanë ndikim në ushtrimin e mandatit të misionit EULEX Kosova si dhe për procedurat gjyqësore që iniciohen si rezultat i hetimeve nga SITF-ja si dhe PSBE-në në zbatimin e mandatit të tyre. [...]'
14. Meqenëse, në pajtim me nenin 16(1) të saj, Kushtetuta 'është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës', obligimi ligjor i lartpërmendur, i mishëruar në Shkëmbimin e Letrave, që është ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës, vlen në rastin e amendamentit të propozuar, i cili, nëse miratohet, do të kishte ndikim në proceset gjyqësore që rezultojnë nga hetimet e TFHS-së, meqenëse amendamenti i propozuar ka për qëllim që të heqë nga Kushtetuta një referencë të Ligjit Nr. 04/L-274 për ratifikimin e Shkëmbimit të Letrave.
15. Sidoqoftë, para se Presidenti i Kosovës t'ia dërgonte amendamentin e propozuar Kryetares së Kuvendit më 24 gusht 202, nuk u mbajtën konsultime me shefin e Misionit EULEX Kosova, që është në kundërshtim me obligimin ligjor të lartpërmendur, i cili është dashur të respektohej, në pajtim me nenin 19(2) të Kushtetutës ku thuhet se "Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe normat juridikisht të detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës".
16. Për këtë arsye parashtrojmë se, pa hyrë në konsideratat e tjera për pranueshmërinë, Referimi është në veçanti i papranueshëm për arsyen se nuk janë zhvilluar konsultimet të cilave u referohen paragrafët 13 dhe 15.
17. Në këtë aspekt, Referimi do t'i mundësonte panelit të Gjykatës Kushtetuese që të shqyrtojë kushtetutshmërinë e procedurës që është ndjekur në procesin e nxjerrjes së amendamentit të propozuar, duke pasur parasysh rëndësinë e ruajtjes së Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar si 'një tribunal i pavarur dhe i paanshëm i themeluar me ligj', siç thuhet në Kapitullin II, nenin 31(2) të Kushtetutës, dhe obligimet ndërkombëtare të Kosovës sipas Shkëmbimit të Letrave.
-